

QK3.

**AKT – THEMELIMI I SHOQËRISË ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

**"SAMAS NL " SH.P.K.**



Shpallur sot më datë 02/10/2020 nga Ortaku :

**Z.Menderes Kjaili i biri i Mahmud i dl.10.05.1963, shtetas i Maqedonise se Veliut lindur ne Chajlane Shkup dhe banues ne Shkup, Maqedoni e Veriut, me zotesi te plete per te vepruar, identifikuar me ane te Kartes se identitetit te leshuar nga Republika e Maqedonise Veriut me Nr.A0786650 dhe Nr.personal 1005963450147.**

I cili bazuar në Ligjin 9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i modifikuar) dhe Ligjit nr. 9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", shpallin sa vijon:

**NENI 1**  
**THEMELIMI I SHOQERISE**

Ortaku **Menderes Kjaili** themelon Shoqerinë me Përgjegjësi të kufizuar:

**"SAMAS NL " SH.P.K.**

Shoqeria, themeluar me inisiativën e ortakeve themelues, konsiderohet e themeluar në përputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutin e saj bashkëngjitur këtij akti.  
Shoqeria i nënshtrohet legjislacionit shqiptar, ndërsa degët që mund të krijohen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë do ti nënshtrohen legjislacionit të vëndit ku do të ketë qendrën dega.

Degët e shoqërisë do të ushtrojnë veprimtarinë në emër dhe për llogari të kësaj shoqërie dhe brënda kompetencave që do tu jenë dhënë me aktet e krijimit apo me akte të tjera të veçanta.

**NENI 2**  
**SELIA E SHOQËRISË**

**Selia e Shoqërisë është në Durres me adresë:**

Durres, Shkallnur, Pall i Shoq."Gasseralb", ZK:3385, Nr.Pasurie 578/321, Ap.5

Shoqeria do të ketë edhe vënd qëndrime të tjera të dyta, filiale dhe përfaqësi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe, me aprovimin e organeve kompetente edhe jashtë tij.

**NENI 3**  
**E DREJTA**

Shoqeria është person juridik i së drejtës shqiptare e themeluar me vendim të ortakut që ushton veprimtarinë e saj tregtare në përputhje dhe në zbatim të legjislacionit shqiptar në fuqi si Ligjit 9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe Ligjit n. 9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" (i

modifikuar) e në përputhje dhe në zbatim të Akitit të Themelimit dhe Statutit të Shoqërisë të përditësuar në përputhje me ligjet e lartëpërmëndura.

NENI 4  
PERGJEGJESIA

Shoqëria vepron në rregimin e pronës private dhe merr përsipër të drejta dhe detyrime.

Shoqëria përgjigjet me pasurinë e saj për detyrimet e saj kontraktore dhe jashtë kontraktore ndaj të tretëve. Ajo nuk përgjigjet për detyrimet e ortakëve në veçanti, por për humbjet e shoqërisë deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar.

Ortaku nuk përgjigjet me pasurinë e tij vetiakë për detyrimet e shoqërisë që vijnë nga veprimitaria që kryen në emër dhe për llogari të shoqërisë me të tretët.

NENI 5  
OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqëria ka për objekt të veprimitarisë së saj:

- Agjenci Imobiliare. Menaxhimi, administrimi, dhënia me qira dhe shitja e pasurive te paluajtshme, investimin dhe/ose zhvillimin e pasurive te paluajtshme.
- Veprimtari ne fushen e ndertimit, ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore si ndertime te banesave, objekteve sociale, rikonstruksione, prodhim materiale ndertimi, punime infrastrukture, rrugesh, ujesjellesa e kanalizime, rehabilitime rrugesh,porte, aeroporte,etj. Germime dheu me punime eventuale murature e betonarme. Prodhim material inerte - gure. Punime karpenterie metalike.
- Prodhim, tregtim i materialeve te ndertimit brenda dhe jashte vendit per vete dhe per te trete, ndertim te impjanteve dhe te stabilimenteve per prodhimin dhe furnizimin e lendeve te para dhe te materialeve te ndertimit te cdo lloji.
- Tregtim te materialeve te ndertimit e te lendeve te para per ndertim, makineri, pajisje dhe pjese kembimi, etj
- Veprimtari ne fushen e turizmit, me qellim ngritjen e hoteleve dhe fshatrave turistike te pushimit, plazheve, qendrave te arketimit brenda dhe jashte vendit, te bleje, te marre me qera, te ndertoje apo te nxise ndertimin e tyre, duke vepruar ne kete fushe e vetme apo me partnere te tjere.
- Tregetim me shumice e pakice te mallrave industriale, dhe ushqimore, bujqesore dhe blegtoriale, lende te para, pjese kembimi per makina, pajisje hidro-sanitare, hidraulike, orendi shtepiake, mobilje, pajisje elektrike e elektronike, elektro – shtepiake, pjese kembimi per automjete,etj.
- Transport brenda dhe jashte vendit per vete, per te trete e me qira

NENI 6

KOHËZGJATJA E VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË



Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje afat te pacaktuar, por sidoqofte mbi 10 vjet, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit me perjashtim te rastit te mbarimit te saj sipas kushteve te parashikuara ne ligj ose me vendim te Asamblese se ortakeve.

NENI 7  
KAPITALI THEMELTAR

Kapitali fillestari i shoqërisë eshte **100.000 (njeqindmije) lekë** dhe përfaqësohet nga kontributi i ortakut themelues dhe eshte i perbere nga **1 kuote**.

**Z.Menderes Kjaili**, eshte zotërues i **1 kuote**, me 100% pjesmarrje në kapitalin e shoqërisë, me vlerë **100.000 leke**.

Kapitali fillestari i shoqërisë do të mund të ndryshojë me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

NENI 8  
DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Asambleja e Ortakëve është organi më i lartë vendimarrës i Shoqërisë që përbëhet nga të gjithë ortakët.

Asambleja e Ortakëve thirret nga administratori, ortak themelues i shoqërisë, ose dhe nga ortakët e shoqërisë sipas nenit 84 të ligjit të cituar.

Vendimet e Asamblese së Ortakëve merren nga ortakët që përfaqësojnë të paktën 51% të kapitalit themeltar të shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme duhet të thirret të paktën një herë në vit. Asambleja e Përgjithshme thirret në çdo rast që është e nevojshme mbrojtja e interesave të shoqërisë.

Administrimi i shoqërisë realizohet nga Administratori i saj **Z.Menderes Kjaili**, i cili emërohet për një afat 5 vjecar dhe ushtron përfaqësimin e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të Zakonshme.

NENI 9  
TE DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKUT

Ortakët kanë të drejta dhe detyrime të barabarta ndaj ligjit.

NENI 10  
BAZA LIGJORE PER NDRYSHIMET

Shoqëria mund të ndryshojë emërtimin e saj, administratorin, kapitalin, selinë, ortakët, objektin e veprimtarisë etj., sipas vendimit që do të merret nga Asambleja e Ortakëve dhe sipas kërkesave të Ligjit 9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe Ligjit n. 9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" (i modifikuar).

NENI 11  
BILANCI

Veprimet ekonomike dhe financiare të shoqërisë do të mbyllen në 31 dhjetor të çdo viti. Viti ushtrimor do të përkøjë me vitin kalendarik. Vetëm për vitin e parë ushtrimor do të kihet parasysh periudha që shtrihet nga momenti i rregjistrimit në organin tatimor deri në datën 31 dhjetor.

### NENI 12

#### FITIMI

Të ardhurat neto të shoqërisë (fitimi) do të ndahen midis ortakëve në mënyrë proporcionale me kuotat përkatëse që ata disponojnë.

### NENI 13

#### OBJEKTIVAT

Paraprakisht, ortakët nuk ndajnë detyrat dhe që të gjithë së bashku do të duhen të bashkëpunojnë për të realizuar zhvillimin e një aktiviteti eficent të shoqërisë.

### NENI 14

#### PERFAQESIMI

E drejta për të përfaqësuar shoqërinë para çdo organi shtetëror, privat, bankar dhe gjyqjësor ushtrohet nga Administratori i Shoqërisë ose nga një person tjetër i autorizuar me nga Administratori.

### NENI 15

#### REZERVA LIGJORE E NDRYSHIMEVE

Ky akt bazohet në legjisacionin shqiptar në fuqi, prandaj, çdo ndryshim i këtij akti do të detyrojë ortakët të bëjnë ndryshimet përkatëse në mënyrë për t'ia përshtatur kërkeseve ligjore.

### NENI 16

#### ZBATIMI I LIGJIT

Përsa nuk është parashikuar në këtë Akt dhe në Statut, vleinë dispozitat e Ligjit Ligjt 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqërítë tregtare" dhe Ligjt n. 9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" (i modifikuar).

### NENI 17

#### JURIDIKSIONI GJYQJESOR

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindi midis ortakëve dhe personave të tretë do të zgjidhet me mirëkuptim, në të kundërt, kompetente do të jetë Gjykata e Rrethit ku ka seline ligjore shoqeria.

### NENI 18

#### VLEFSHMERIA E AKTIT TE THEMELIMIT

Akti i themelimit hartohet në katër kopje origjinale, pasi u lexua dhe u gjend konform vullnetit të lirë të ortakut themelues, nënshkruhet rregullisht prej tij .

#### **ORTAKU I SHOQERISE**

Menderes Kjallı

Menderes Qilibi



## STATUTI I SHOQËRISË ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

" SAMAS NL " SH.P.K.

### KREU I

#### EMËRTIMI, SELIA, KOHËZGJATJA, AKTIVITETI, PARIMI I DETÝRIMIT TE BESNIKËRISË

##### NENI 1

#### EMËRTIMI I SHOQËRISË DHE ORTAKET E SHOQERISE

Shoqëria emërtohet "**SAMAS NL**" Shpk. Ajo është person juridik dhe zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me Aktin e Themelimit, me Statutin dhe legjispcionin shqiptar në fuqi.

Kjo Shoqeri krijuhet nga:

**Z.Menderes Kjaili** i biri i Mahmud i dli. 10.05.1963, shtetas i Maqedonise se Veiut lindur ne Chajlane, Shkup dhe banues ne Shkup, Maqedoni e Veriut, me zotesi te plotë per te vepruar, identifikuar me ane te Kartes se identitetit te leshuar nga Republika e Maqedonise se Veriut me Nr. A0786650 dhe Nr. personal 1005963450147.

##### NENI 2 SELIA E SHOQËRISË

Selia e Shoqërisë është në Durres me adresë:

Durres, Shkallnur, Pall i Shoq."Gasseralb", ZK:3385, Nr.Pasurie 578/321, Ap.5.

Shoqëria do të ketë edhe vënd qëndrime të tjera të dyta, filiale dhe përfaqësi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe, me aprovimin e organeve kompetente edhe jashtë tij.

##### NENI 3 KOHËZGJATJA E VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje afat te pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit me perjashtim te rastit te mbarimit te saj sipas kushteve te parashikuara ne ligj ose me vendim te Asamblese se ortakeve.

##### NENI 4 OBJEKTI I VEPRIMTARISË



Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë së saj:

- Agjenci Imobiliare. Menaxhimi, administrimi, dhenia me qira dhe shitja e pasurive te paluajtshme, investimin dhe/ose zhvillimin e pasurive te paluajtshme.
- Veprimtari ne fushen e ndertimit, ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore si ndertime te banesave, objekteve sociale, rikonstruksione, prodhim materiale ndertimi, punime infrastrukture, rrugesh, ujesjellesa e kanalizime, rehabilitime rrugesh, porte, aeroporte, etj. Germime dheu me punime eventuale murature e betonarme. Prodhim material inerte - gure. Punime karpenterie metalike.
- Prodhim, tregtim i materialeve te ndertimit brenda dhe jashte vendit per vete dhe per te trete, ndertim te impjanteve dhe te stabilimenteve per prodhimin dhe furnizimin e lendeve te para dhe te materialeve te ndertimit te cdo lloji.
- Tregtim te materialeve te ndertimit e te lendeve te para per ndertim, makineri, pajisje dhe pjese kembimi, etj
- Veprimtari ne fushen e turizmit, me qellim ngritjen e hoteleve dhe fshatrave turistike te pushimit, plazheve, qendrave te arketimit brenda dhe jashte vendit, te bleje, te marre me qera, te ndertoje apo te nxise ndertimin e tyre, duke vepruar ne kete fushe e vetme apo me partnere te tjere.
- Tregetim me shumice e pakice te mallrave industriale dhe ushqimore, bujqesore dhe blegtoriale, lende te para, pjese kembimi per makina, pajisje hidro-sanitare, hidraulike, orendi shtepiake, mobilje, pajisje elektrike e elektronike, elektro-shtepiake, pjese kembimi per automjete, etj.
- Transport brenda dhe jashte vendit per vete, per te trete e me qira

NENI 5  
E DREJTA

Shoqëria është person juridik i së drejtës shqiptare e themeluar me vendim të ortakëve që ushtron veprimtarinë e saj tregtare në përputhje dhe në zbatim të legjislacionit shqiptar në fuqi si Ligjit 9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe Ligjit n. 9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" (i modifikuar) e në përputhje dhe në zbatim të Aktit të Themelimit dhe Statutit të Shoqërisë të përditësuar në përputhje me ligjet e lartëpërmëndura.

NENI 6

## PARIMI I DETYRIMIT TË BESNIKËRISË

Gjatë ushtrimit të të drejtave ortakët e shoqërisë veprojnë duke marrë parasysh interesat e shoqërisë dhe të ortakëve. I njëjti detyrim zbatohet edhe për administratorin e shoqerise.

### KREU II

#### KAPITALI THEMELTAR, TRANSFERIMI I KUOTAVE TË KAPITALIT THEMELTAR, ANULLIMI I KUOTAVE, E DREJTA E PRONËSISË SË SHOQËRISË, ADRESA E ORTAKËVE, VULA E SHOQËRISË

##### NENI 7

###### KAPITALI THEMELTAR

Kapitali fillestar i shoqërisë eshte 100.000 (**njeqindmije**) lekë dhe përfaqësohet nga kontributi i ortakut te vetem dhe eshte i perbere nga 1 **kuote**.

**Z. Menderes Kjaili**, eshte zotërues i 1 **kuote**, me 100% pjesmarrje në kapitalin e shoqërisë, me vlerë 100.000 leke.

Kapitali fillestar i shoqërisë do të mund të ndryshojë me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

##### NENI 8

###### TRANSFERIMI I KUOTAVE TË KAPITALIT THEMELTAR

Kuotat e kapitalit mund të shiten nga ortakët e shoqërisë me vleren nominale ose sipas një vlere tjeter të pranuar midis shitësit dhe blerësit. Shitia e kuotave duhet të jetë në përputhje me kuotat e poseduara nga ortakët dhe ju bëhet e njojur me akt të shkruar dhe regjistruar në rregjistrin e shoqërisë.

##### NENI 9

###### TRANSFERIMI I KUOTAVE TË TRETEVË

Kuotat e kapitalit themeltar mund tu transferohen lirisht personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri nese ky vendim është i aprovuar nga ortakët që përfaqësojnë totalisht të paktën 51% të kuotave të kapitalit të shoqërisë.

##### NENI 10

###### TRANSFERIMI I KUOTAVE ME TRASHËGIMI

Kuotat e kapitalit, në rast vdekjeje i kalojnë trashëgimtarëve duke hyrë këta të fundit në shoqëri me të gjitha të drejtat e ortakut.

##### NENI 11

###### ANULLIMI I KUOTAVE NGA SHOQËRIA

Mund të proçedohet në anullimin e kuotave mbi të gjitha kur sjellja e ortakut është pengesë në kryerjen e aktivitetit dhe detyrave statutore të shoqërisë. Në këtë rast, ortakut i likujdohet megjithatë vlera e kuotës te tij dhe kuotat e tij u ndahen ortakëve të tjerë që bëjnë kërkesë në mënyrë gjithmonë proporcionale me kuotat e kapitalit që tashmë disponojnë.

NENI 12  
PËRGJEGJËSIA E SHOQËRISË

Shoqëria vepron në rregjinin e pronës private dhe merr përsipër të drejta dhe detyrime.

Shoqëria përgjigjet me pasurinë e saj për detyrimet e saj kontraktore dhe jashtë kontraktore ndaj të tretëve. Ajo nuk përgjigjet për detyrimet e ortakëve në veçanti, por për humbjet e shoqërisë deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar.

Ortakët nuk përgjigjen me pasurinë e tyre vetiakë për detyrimet e shoqërisë që vijnë nga veprimitaria që kryejnë në emër dhe për llogari të shoqërisë me të tretët.

NENI 13  
ADRESA E ORTAKËVE

Adresa e ortakëve përsa i përket marrdhënieve të tyre me shoqerinë është ajo e regjistruar në librin e ortakëve themelues të shoqërisë e cila mund te përditësohet. Do te jete detyrim i ortakëve të komunikojnë me shkrim me anë të rekomandesë me lajmërim marrje që vërteton dorëzimin efektiv në një vendbanim te ndryshem nga ai i deklaruar me parë. E njejta proçedurë do të zbatohet për çdo përditësim të mëtejshëm.

NENI 14  
VULA E SHOQËRISË

Shoqëria ka vulën e saj me të njëjtin emërtim si vetë shoqëria. Përdorimi i vulës është i rezervuar eksluzivisht administratorit, me përjashtim të një ortaku tjetër që të jetë posaçërisht i deleguar.

KREU III  
ASAMBLEJA E ORTAKËVE, E DREJTA E VOTËS, PROÇESVERBALET E  
MBLEDHJES SË ASAMBLESË SË ORTAKËVE ADMINISTRIMI I  
SHOQËRISË, DETYRIMI I BESNIKËRISË DHE PËRGJEGJËSIA

NENI 15  
ASAMBLEJA E ORTAKËVE

Asambleja e Ortakëve është organi më i lartë vendimarrës i Shoqërisë që përbëhet nga të gjithë ortakët.

Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqerinë për çështjet e mëposhtme:

- përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;

- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- d) emërimin dhe shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti;

- \* Vendimet e Asamblese se Ortakeve janë te vlefshme nese merren nga ortaket që përfaqësojnë të paktën 51% të kapitalit themeltar të Shoqerise
- \* Asambleja e Përgjithshme duhet të thirret të paktën 1 herë në vit.
- \* Asambleja e Përgjithshme thirret në çdo rast që është e nevojshme mbrojtja e interesave të shoqërisë.
- \* Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpëra datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

NENI 16  
E DREJTA E VOTËS

Çdo ortak ka te drejta vote ne perpjasetim me vleren nominale te kuotes se tij. Asnjë ortak nuk voton në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme nëse nuk ka shlyer tërësisht detyrimet, që kanë të bëjnë me kuotat, që ai disponon.

Ortakët që nuk janë të pranishëm mund të marrin pjese në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve. Mjetet elektronike përfshijnë, por pa u kufizuar në to: a) transmetimin e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në kohë reale; b) komunikimin e ndërsjellë në kohë reale, i cili u mundëson



ortakëve /të shprehen përmblledhjen e asamblesë së përgjithshme nga një vendndodhje tjetër; c) mekanizma, që mundësojnë procesin e votimit, përpara apo gjatë mbajtjes së mbledhjes së asamblesë se përgjithshme, pa qenë nevoja të caktohet një përfaqësues i autorizuar, përmarrë pjesë fizikisht në mbledhje.

Përdorimi i mjeteve elektronike, përmarrin pjesë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, bëhet me kushtin që të merren masat teknike të nevojshme përmarrë përgjithshme, deri në atë masë që ky përdorim të jetë proporcional me arritjen e këtyre qëllimeve.

Ortakët kanë të drejtën, që u njihet nga ky ligj apo statuti, përmarrë unanimisht çdo vendim, me kusht që kjo marrëveshje të bëhet me shkrim.

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim përmarrë: a) vlerësimin e veprimtarisë së tij; b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij; c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria; ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

NENI 17  
PROCESVERBALET E MBLEDHJES SË ASAMBLESË

Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët përgjigjen përmarrësve si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme. Procesverbalit i mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit. Procesverbalit i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit. Nëse shoqëria ka publikuar një faqe në internet, administratorët, jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes, janë të detyruar të publikojnë kopje të procesverbalit të mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në këtë faqe.

NENI 18  
ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Administrimi i shoqërisë realizohet nga administratori i saj **Z. Menderes Kjaili** i cili emërohet përmarrës i 5 vjecar dhe ushtron përfaqësimin e shoqërisë. Konkretnisht, administratori ka të drejtë e detyrohet të: a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura



nga ăsambleja e përgjithshme; b) përfaqëson shoqërinë tregtare; c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë; ç) përgatit dhe nënshkruan bilançin vjetor, bilançin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara ăsamblësë së përgjithshme për miratim; d) krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë; dh) kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit; e) raporton përpara ăsamblësë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare; ë) kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Në rastet e parashikuara nga pikat 3 e 5 të nenit 82 të këtij ligji, administratori eshte i detyruar të thërrasi asamblenë e përgjithshme.


Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

NENI 19  
DETYSIMI I BESNIKËRISË DHE PËRGJEGJËSIA

Administratori, përveç sa ăshtë parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të këtij ligji, detyrohet: a) të kryej detyrat e tij të përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis; b) të ushtrojë kompetencat që u njihen në ligj ose në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita; c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim; ç) të parandalojë dhe mënjanojnë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë; d) të garantojë miratimin e marrëveshjeve sipas dispozitave të pikës 3 të nenit 13 të këtij ligji; dh) të ushtrojë detyrat e tyre me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

Administratori, gjatë kryerjes së detyrate të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mos veprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi ăshtë kryer në mirëbesim.

Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, ăshtë i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet,



që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka parrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, kryen veprimet e mëposhtme: a) u kthen ortakëve kontributet; b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë; c) u shpérndan aktivet shoqërisë; ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet; d) jep kredi.

NENI 20  
PRISHJA E SHOQËRISË

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet: a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj; b) me vendim të asamblesë së përgjithshme; c) me hapjen e procedurave të falimentimit; ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit"; d) me vendim të gjykatës; dh) për arsyet e tjera, të parashikuara në statut.

NENI 21  
LARGIMI I ORTAKËVE

Ortaku mund të largohet nga shoqëria nëse ortakët e tjerë ose shoqëria kanë kryer veprime në dëm të tij, nëse është penguar të ushtrojë të drejtat e tij, nëse shoqëria i ka ngarkuar detyrimet të paarsyeshme apo për shkaqe të tjera, që e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë. Ortaku që kërkon largimin, duhet të njoftojë shoqërinë me shkrim, si dhe të parashtrojë shkaqet e largimit.

Administratorët duhet të thërrasin mbledhjen e asamblesë së përgjithshme menjëherë pasi të kenë marrë dijeni për njoftimin e largimit, sipas paragrafit te pare te këtij neni, për të vendosur nëse ortakut do t'i likuidohet kuota, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme. Ortaku ka të drejtë të ngrejë padi në gjykatë ndaj shoqërisë për likuidimin e kuotës, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme, nëse pas njoftimit të largimit asambleja e përgjithshme nuk mblidhet apo nuk njeh si të arsyeshme shkaqet e largimit dhe likuidimin e kuotës.

Ortaku që kërkon largimin nga shoqëria, detyrohet ta dëmshpérblejë shoqërinë për dëmet e shkaktuara, nëse

rezulton se largimi eshtë kryer në bazë të shkaqeve të paarsyeshme. Ortaku që largohet ka të drejtë të ngrëjë padi ndaj shoqërisë dhe/ose ortakëve të tjerë që shkaktuan largimin e tij dhe të kërkojë ndaj tyre, në mënyrë solidare, shpërblimin e dëmit të pësuar. Të gjitha të drejtat, që rrjedhin nga cilësia e ortakut në shoqëri, shuhën në datën e largimit. Statuti nuk mund të përjashtojë apo të kufizojë të drejtën e ortakut për t'u larguar nga shoqëria.

NENI 22  
PËRJASHTIMI I ORTAKËVE

Në bazë të një vendimi të zakonshëm, asambleja e përgjithshme mund t'i kërkojë gjykatës përjashtimin e ortakut, nëse ai nuk ka shlyer kontributin e tij, sipas parashikimeve të statutit ose nëse ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme për këtë përjashtim. Konsiderohen shkaqe të arsyeshme për përjashtimin e ortakut, sipas pikës 1 të këtij nenit, por pa u kufizuar në to, rastet kur ortaku: a) me dashje apo me pakujdesi të rënde shkakton dëme shoqërisë ose ortakëve të tjerë; b) me dashje apo me pakujdesi të rëndë shkel statutin ose detyrimet e përcaktuara me ligj; c) përfshihet në veprime, të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënieve midis shoqërisë tregtare dhe ortakut; ose ç) me veprimet e tij dëmton ose pengon ndjeshëm veprimtarinë tregtare të shoqërisë.

Gjatë procedurës së përjashtimit të ortakut, me kërkeshë të paditësit, gjykata mund të marrë një masë për sigurimin e padisë, duke pezulluar të drejtën e votës së ortakut, që kërkohet të përjashtohet, si dhe të drejtat e tjera, që rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, kur ajo e vlerëson këtë masë si të nevojshme dhe të justifikuar.


Shoqëria ka të drejtë t'i kërkojë ortakut të përjashtuar shpërblimin e dëmit të pësuar nga veprimet, që kanë sjellë përjashtimin.

Ortaku ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë shpërblimin e dëmit të pësuar, nëse kërkesa për përjashtim nuk është e bazuar.

Ortaku nuk ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë likuidimin e kuotës, nëse ai përjashtohet për shkaqe të arsyeshme, por, nëse shoqëria ngrëndaj tij padi për shpërbim dëmi, ortaku ka të drejtë të kompensojë çdo shumë, që do të kishte të drejtë ta përfitonë në cilësinë e likuidimit të kuotës, me dëmin e kërkuar nga shoqëria.

Të gjitha të drejtat, që rrjedhin nga cilësia e ortakut në shoqëri, shuhën në datën e vendimit të formës së prerë të gjykatës përjashtimin. Statuti nuk mund të përjashtojë apo të kufizojë të drejtën e shoqërisë për të përjashtuar ortakun.

NENI 23  
LIKUJDIMI I SHOQËRISË



Me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi, prishja e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ka si pásojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, sipas neneve 190 deri në 205 të ligjit 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

KREU IV  
ZBATIMI I LIGJIT  
NENI 24  
ZBATIMI I LIGJIT

Përsa nuk është parashikuar në këtë Statut vlejnë dispozitat e ligjit 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

NENI 25

Ky akt u redaktua në 3 kopje për tju shpërndarë ortakeve dhe organeve kompetente dhe një kopje mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

**ORTAKU I SHOQËRISË**

Menderes Kjaili

Menderes Kjaili (Handwriting)

Date 02.10. 2020

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE DURRËS  
NOTER FLORIAN F. HOXHA**



V202001171038730781

**DATE 02/10/2020**

**NR REP 1162**

**VËRTETIM NËNSHKRIMI**

Sot, më datë 02.10.2020 (Dymije e njëzet), para meje Noter FLORIAN F. HOXHA, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore DURRËS, me zyrë në adresën Durres, NR.11, ALEKSANDER GOGA, NR.641, NR.27, u paraqit personalisht:

**NËNSHKRUUES/IT:**

Menderes **Kjaili**, atësia Mahmud, amësia Nedxhie, shtetas Shqiptar, lindur në Chajlane dhe banues në Shkup, me adresë UL.10 BR.39, lindur më 10/05/1963, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. A0786650 dhe nr. personal 1005963450147 .

Subjekti i mesiperm, ne vullnet te lire dhe te plote, u paraqit dhe nenshkruajti perpara meje Noterit “Akt-Themelin” dhe Statutin “ bashkelidhur te shoqerise te emertuar ”SAMAS NL“ Shpk.

Unë Noter/ja, pasi verifikova identitetin e personit të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërrma “ë”, si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 “Për Noterinë”, dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre. Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënavë Personale”, unë noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.



**NOTER  
FLORIAN F. HOXHA**

*[Signature]*